



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2008, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS SË
MJEKËSISË FAMILJARE NË LAGJEN "MUHAXHIRËT" NË PRISHTINË

Neni 1

1.1 Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen "Muhaxhirët", në Prishtinë.

1.2 Lokacioni, nga paragr. 1 i këtij neni, përfshinë pjesët e ngastrës kadastrore nr. 7091/1 dhe 7091/63, në sipërfaqe prej 0.15.00 ha, Zona kadastrore - Prishtinë.

Neni 2

Ndërtimi i objektit, sipas këtij Vendimi, do të bëhet në bazë të programeve dhe përmbytjeve tjera të nevojshme për objekte me destinim të këtillë, të hartuara nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës.

Neni 3

3.1 Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

3.2 Nga aspekti i realizimit të lokacionit do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa nga aspekti i realizimit të objektit do të kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Komunës së Prishtinës.

3.3 Sektori i kadastrit do t'i kryejë veprimet procedurale të nevojshme nga përgjegjësia e tij për zbatimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa tekstuale dhe grafike e situacionit të lokacionit të nenit 1 të këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. 353-861, më 25.6.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa